

Ina HOXHAI u lind më 24.06.1987. Është e martuar dhe ka një fëmijë. Në vitet 2006-2010 kreu studimet në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit të Tiranës.

Në periudhën 2012–2015 ka kryer studimet në Shkollën e Magjistraturës, profili “Gjyqtar”. Në punimin e diplomës ka zhvilluar monografinë “Roli i gjykatës në procesin e të provuarit gjatë gjykimit në shkallë të parë”.

Në nëntor të vitit 2014 është emëruar gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë ku ka ushtruar detyrën deri në muajin korrik të vitit 2015. Në 23.06.2016 është emëruar gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pogradec. Që prej muajit janar të vitit 2018 është komanduar si ndihmësmagjistrat pranë Gjykatës së Lartë ku vazhdon detyrën edhe sot.

Që prej vitit 2018 është përzgjedhur në pozicionin e lehtësuesit në programin e trajnimit vazhdues pranë Shkollës së Magjistraturës për tema të ndryshme në fushën e së drejtës procedurale civile. Po ashtu, që prej vitit 2018 është përfshirë në procesin e mësimdhënies në ciklin e studimeve “Bachelor” dhe “Master” pranë Universitetit “Tirana Business University”.

Është autore e disa artikujve në revistën juridike “Avokatia”, si: “Dimensioni Civil i Prezumimit të Pafajsisë”; “Pohimi dhe heshtja si mjet prove në gjykimin civil”; “Juridiksioni në mosmarrëveshjet e punës”.